



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1027/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë ne Prishtinë, me gjyqtaren Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Shani Shehu B.I., me numër të biznesit 80414137 dhe seli në Rahovec, rr. “Xhelal Hajda”, p.nr., duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, te parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1442/22 të datës 29.05.2023, me datë 25.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit “Shani Shehu B.I., me numër të biznesit 80414137 dhe seli në Rahovec, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1442/22 të datës 29.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1442/22 të datës 29.05.2023, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar propësimin e debitorit Shahin Shehu B.I., me seli në Rahovec, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 360/21, i lejuar me datë 02.04.2021, nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani dhe Urdhri Përmbartimor P.nr. 360/21, i lejuar me datë 02.04.2021, nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani, MBETET NË FUQI.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Përgjigje ndaj ankesës së debitorit ka ushtruar kreditori me pretendimin se nuk qëndrojnë arsyet e dhëna nga debitori në ankesën e tij. Propozon që të refuzohet ankesa e debitorit dhe të vërtetohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues- Aktvendimit Nr. 4826, të datës 06.12.2019, i cili ka marr formë të prerë më datën 10.01.2020 dhe është bërë i ekzekutueshëm me datë 26.01.2020, ka lejuar urdhrin përmbartimor P.nr. 360/21, të datës 02.04.2021, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t'ia paguaj shumën në lartësi prej EUR 5,000.00, në emër të gjobës administrative, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani, duke vepruar sipas propozimit për përmbartimin e kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr. 360/21, i lejuar me datë 02.04.2021, e ka caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke theksuar se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk është i përshtatshëm për përmbartim për arsye se i njëjti nuk mban vulën e plotfuqishmërisë e as të ekzekutueshmërisë. Për këtë arsye, ka theksuar se urdhri është marr me shkelje të dispozitave të LPP-së. Ka shtuar se aktvendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk i është dorëzuar debitorit personalisht, për çka janë shkel dispozitat procedurale. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe ka theksuar se pretendimi se nuk e ka pranuar aktvendimin-gjobën debitori nuk qëndron, pasi që me datën 10.12.2019 ka pranuar atë dhe nuk e ka shfrytëzuar kohën prej 30 ditësh që të bëjë ankesë në shkallën e dytë të Komisionit Shqyrtues të Ankesave të KPMM-së, dhe se si rezultat i mos paraqitjes së ankesës nga debitori, aktvendimi është bërë i plotfuqishëm me datë 10.01.2020 dhe i ekzekutueshëm me datën 26.01.2020. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr. 1442/22 të datës 29.05.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka arsyetuar se Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor përkatësisht Aktvendimin Nr. 4826, të datës 106.12.2019, mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, pika 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Po ashtu, gjykata në shkallë të parë ka vlerësuar se në rastin konkret aktvendimi mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim,*

organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: “Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”, ngase i njëjti është bërë i plotfuqishëm me datën 10.01.2020, dhe i ekzekutueshëm me datë 26.01.2020.

Gjykata në shkallë të parë ka vlerësuar edhe pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se nuk ka pranuar më parë aktvendimin mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, mirëpo të njëjtat i gjeti si të pabazuara ngase nga fletë kthesa e postës e cila gjendet në shkresa të lëndës, rezulton se debitori aktvendimin në fjalë e ka pranuar me datë 10.12.2019.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktvendimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale Aktvendimit Nr. 4826, të datës 06.12.2019, i cili ka marr formë të prerë më datën 10.01.2020 dhe është bërë i ekzekutueshëm me datë 26.01.2020, ka lejuar urdhrin përmbarimor P.nr. 360/21, të datës 02.04.2021, është dokument përmbarues, konform nenit 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton se *“dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (ujdia”, nenit 24 par.3 të LPP i cili thotë se: “vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë” si edhe nenit 27 paragrafi 1, i cili thotë se: “dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Nga del se edhe kjo gjykatë pranon përfundimin juridik te

gjykatës se shkalles se parë se aktvendimi i KPMM Nr. 4826, të datës 06.12.2019 përbën titull juridik për përmbarim si dhe konsideron se gjykata e shkalles se parë ka konstatuar drejtë rrethanat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi përfshirë kushtet nga të cilat varet lejueshmëria e përmbarimit.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkalles e Dytë ne Prishtinë për te vendosur nga ana e gjyqtarit individual ne shkallë te dytë bazohet ne dispozitën e nenit 3 par.2 te LPP me te cilën është paraparë se ne shkallen e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.1027/23, me datë 25.10.2023

Gjyqtarja
Saranda Bogaj-Sheremeti